

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylja, në lëndën penale kundër të pandehurit F. L , për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i përfaqësuar nga mbrojtësi, av....., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr. 591/16 të dt. 03.05.2016, të cilin e përfaqësonte Prokurorja e shtetit, Rozelida Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit filllestar gjyqësor dhe publik më të mbajtur më dt. 31.03..2017, ndersa më date 24.04.2017 hartoi këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **F. L.** , nga babai N dhe nëna R.e lindur Sh, I lindur më dt..., në fsh. K. e P , ku edhe jeton, student , I punësuar , I pa martuar, I gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas I R. të Kosovës, më pare I pa denuar si dhe nuk udhëhiqet procedure tjetër penale ndaj tij. 1

Është fajtor

Më dt. 29.03.2016, rreth ores 13,15 minuta, në Gj, në rrugën Lidhja e P e pandehura G. B nga pakujdesia me lëshime primare ka rrezikuar trafikun public duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës, ..., me tabela të regjistrimit ...ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 42.1 të Ligjit për sigurinë e Komunikacionit Rrugor të Republikës së Kosovës, ashtu që duke bërë vozitje mbrapa, nga trotoari të autolarja “...” kyqet në rrugë kryesore, pa u siguruar mire se këtë veprim do ta bëjë pa rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ndërsa I pandehuri F. L. nga pakujdesia me lëshime sekondare ka rrezikuar trafikun public duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës VW Polo, me tabela të regjistrimitka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 54.1, të ligjit për sigurinë e Komunikacionit Rrugor të R. të Kosovës, ashtu që nuk ka përshtatur shpjegimin e lëvizjes kushteve të rrugës, për ta ndalur automjetin para qdo pengese të paraqitur në rrugë, kalon në shiritin e kundërt qarkullzes dhe direct ndeshet e godet automjetin e markës “...me tabela regjistrimi ...-...”, të cilin e voziste J. S., I cili ishte duke qarkulluar në drejtim të qendrës së Gj dhe si pasojë shkaktohet aksident komunikacioni, ka përpos dëmeve material në të dy automjetet, lëndime të lehta trupore pësojnë Jusuf Saiti dhe pasagjëri I tij H. R, të cilët për shkak të natyrës së lëndimeve të pësura detyrohen të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Rajonal në Gj .

Me çka ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,7,41,49, 50, 51, 52 , 73, 74, 75,dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 233 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqiptohet :

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit F. L, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzikutohet nëse i pandehuri brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t`iu revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari J. S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 591/16 të dt. 03.05.2016, kundër të pandehurit, ..., për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-ës.

Prokuroria Themelore Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan me 17.03.2017 ka paraqitur marrëveshjen për praninë të fajësisë, të nënshkruar nga Prokurori i shtetit, i pandehuri F. L dhe mbrojtësi i tij, av.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit, Rozelida Hasani, i pandehuri, i, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.....

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 36 të KPPRK-së ka veqar procedure penale për të pandehuren....

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se mbes në tërsi pranë marrëveshjes për praninë të fajësisë, të datës 17.03.2017, nga se janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të KPPRK-së, andaj kemi arritur marrëveshje me të pandehurin Besnik Hajrizi për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, me të cilin rast i njëjti është pajtuar që të pranojë fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, edhe atë gjithnjë, në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij .

Mbrojtësi i të pandehuritdeklaroi : siç theksoi edhe Prokurorja e shtetit pas konsultimeve të bëra me klientin tim ...me 76.03.2017, pranë Prokurorisë Themelore në Gjilan, kemi arritur marrëveshjen për praninë të fajësisë, në lidhje me veprën penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, në mënyrë që i mbrojturi im të përfiton të gjitha benefitet që janë të përcaktuara në dispozitat ligjore.

I pandehuri ...deklaroi: në tërsi mbes në deklaratën e mbrojtësit.

Pas dëgjimit të palëve, gjykata në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21 të KPPK-së , konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë, lidhur mes PTH-së – DP, në njërën anë dhe të pandehurit ...me mbrojtësin e tij, avokatin ...në anën tjetër për kryerjen e veprës penale, sipas dispozitivit të aktakuzës PP.II.nr. 591/16 të dt. 03.05.2016.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 233 paragrafi 21, fjalia e dytë të KPPK-së, po ashtu vendosi që data e sotme të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin.

Prokurorja e shtetit Rozelida Hasani deklaron: duke marrë parasysh se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore të parapara sipas kodit 233 për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, kërkoj nga gjykata që të pandehurin e sipërtheksuar ta shpalli fajtor për veprën penale të cilën ia vë në barrë aktakuza, dhe në pajtim me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, të njëjtit t'i shqiptojë sanksionin penal të paraparë në këtë marrëveshje.

Mbrojtësi i të pandehurit..., avokati, ...deklaroj: meqë jemi dakorduar edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë lidhur me dënimin, i propozoj gjykatës që të njëjtin dënim t'ia shqiptoi të pandehurit Besnik Hajrizi.

Pas pranimit të marrëveshjes të pranimit të fajësisë për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv me numër dhe datë të shënuar si më lart, si dhe deklaratave te palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurin e cekur më lartë , e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit. Me dënimin e shqiptuar të pandehurit gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimin ashtu që të pandehurin do ta parandaloj që të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale dhe se ky dënim edhe për qytetarët e tjerë, do të ketë efekt preventues nga kryerja e veprave të ngjajshme penale .

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag.1, e në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së.

I dëmtuari...,në pajtim me nenin 463 të KPPK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan, - Departamenti i përgjithshëm
Më 24.04.2017

Sekretarja juridike
Rafete Sylja, d.V.

Gjyqtari
Islam Thaçi ,d.V.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

